



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj
Adresa: Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, Kati i 8, pranë Stacionit të Trenit, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” **“Pastrimi i pjesës Perëndimore - 3 të Qytetit të Tiranës”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Pastrimi i pjesës Perëndimore - 3 të Qytetit të Tiranës”.

Fondi limit: 189,069,931 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2016, miratuar me VKB Nr. 58, datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”.

Kohëzgjatja e kontratës: 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 01.06.2016, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 16 datë 25.04.2016.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio”shpk

NUIS K91413010N

Vlera e ofertës = **0** (zero) lekë.

2. Operatori ekonomik “Silver” shpk

NUIS K88010301S

Vlera e ofertës = **175,069,931** (njëqind e shtatëdhjetë e pesë milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk NUIS K32712206U

Vlera e ofertës = **178,006,971.84** (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj

NUIS K91326028I

Vlera e ofertës = **184,834,584** (njëqind e tetëdhjetë e katër milion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Infinit Constructions” shpk

NUIS J62904100D

Vlera e ofertës = **188,907,876** (njëqind e tetëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk

NUIS K13820210W

Vlera e ofertës = **188,993,031** (njëqind e tetëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “Rej” shpk

NUIS J93711608Q

Vlera e ofertës = **189,047,781** (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milion e dyzetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk

- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Pastrime Silvio” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.
- Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- Gjithashtu Nuk ka paraqitur dokumentet e kërkuara në pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit përkatësisht Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 8 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.
- Nuk ka paraqitur dokumentet e kërkuara në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit përkatësisht:
 - Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
 - Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;
 - Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1
- Operatori ekonomik pastrime Silvio Shpk ka paraqitur vërtetimin nr.5536.prot, datë 07.03.2016 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për xhiron e tre viteve të fundit 2013, 2014, 2015 nga ku rezultojnë se xhiro mesatare për këtë periudhë është në vlerën 98.842.913 lekë. Për rrjedhojë nuk plotëson pikën 2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit “Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2013, 2014, 2015) lëshuar nga Autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: **189,069,931** (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH”.
- Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në pikën 2, të Kapacitetit Teknik për plotësimin e kërkesës lidhur me “Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për Zonën Perëndimore - 3 të qytetit të Tiranës, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
 - Libreze pune (përkatëse)
 - Diplomë
 - CV përkatëse
- Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës në ofrimin e shërbimit të pastrimit.
- Për asnjë nga kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik Pastrime Silvio Shpk nuk është paraqitur vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitim të këtyre mbetjeve. Kjo në kundërshtim me pikën 1 të Kapacitetit Teknik, të kriterëve të Veçanta të Kualifikimit
- Nuk përmbush pikën 3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të përmbushur kërkesën lidhur me “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë staf teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV dhe të figurojnë në listpagesa:
- Inxhinier Mekanik (1)
- Nuk plotëson kërkesat e pikës 10 dhe 11 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur dokumente për përmbushjen e kërkesave mbi disponimin e makinerive të kërkuara sipas pikës 10 dhe dokumentacionin shoqëruar e

deklaratat përkatëse të përcaktuara në pikën 11 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pika 2.2 Kapaciteti Teknik.

2. Operatori ekonomik “Silver” shpk

- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori ekonomik “Silver” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentat si më poshtë vijon:
 - Shtojca 1 “Formulari i Ofertës” ;
 - Vërtetimin me Nr. 5607 Prot. datë 24.03.2016 lëshuar nga Administrata Tatimore për shlyerjen e detyrimeve fiskale si dhe detyrimeve të sigurimeve shoqërore;
 - Vërtetimin me Nr. 5606 Prot. datë 24.03.2016 lëshuar nga Administrata Tatimore mbinumrin e punonjësve për periudhën Janar 2015 – Shkurt 2016;
 - Kopje e Bilancit për vitin ushtrimor 2013;
 - Kopje e Bilancit për vitin ushtrimor 2014;
 - Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve Teknike;
 - Deklaratë mbi konfliktin e interesit;
 - Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore.
- Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në Procesverbalin e Vlerësimit të Ofertave.
- Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor e teknik si dhe mungesa e Preventivit të detajuar sipas zërave të shërbimit u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk

- Operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k për plotësimin e pikës 10, germa k) dhe j) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit ka paraqitur mjetet me targë AA032LO, AA769LV, AA186LN, AA830MY në pronësi të Viktoria Invest Shpk. Rezulton se vetëm mjeti me targë AA769LV është autobot uji, ndërsa mjetet e tjera të paraqitura rezultojnë mjete cisternë për transport vajra dhe karburante kategoria C2. Për rrjedhojë operatori ekonomik Viktoria Invest Shpk nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në germa k) dhe j) pika 10, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit përkateësisht për dispinimin: “Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998 jo më pak se **2 (dy) copë**; dhe “Makina për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë**”.
- Operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k për plotësimin e pikës 10, germa i) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit ka paraqitur deklarata doganore për dy mjete për fshirjen e rrugëve: makineri për pastrimin e rrugëve e përdorur marka Karcher ICC2 dhe makinë për pastrimin e rrugëve Mod ICC2D . Dokumentacioni i paraqitur për

disponimin e këtyre mjeteve është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 11, germa c) përkatësisht “Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si leje qarkullimi, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme)”.

- Operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 10 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, germa d) për paraqitjen e “Makinë transportuese të kontenerëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenerëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë**”. Mjeti i paraqitur nga Operatori Ekonomik Viktoria Invest shpk përkatësisht mjeti me targë AA132MD është mjet i pajisur me vinç dhe jo me platformë ngarkimi siç kërkohet në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k për lotësimin e pikës.10 germa e) . të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit ka paraqitur mjetet me targë EL9868B me kontratë qeraje dhe mjetet në pronësi të Viktoria Invest përkatësisht AA120NE, AA718MJ, AA467LN dhe AA187LN.
- Makineritë e paraqitura nga Operatori Ekonomik “Viktoria Invest” shpk përkatësisht Mjeti i paraqitur me targë AA120NE është pa foto dhe e vitit të prodhimit 1997, mjeti AA718MJ, AA467LN dhe mjeti AA187LN nuk janë gazelona për transport të mjetëve por kamion të hapur. Për rrjedhojë Operatori ekonomik “Viktoria Invest” Shpk nuk plotëson pikën 10 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, germa e) të Dokumentave Standarte të tenderit për paraqitjen e jo më pak se **4 (katër) copë** “Makinë e vogël transportuese, vetëshkarkuese (gazelona), me peshë mbajtëse 1-1.4 ton dhe kapacitet mbajtës 2.5-3.3 m3. Viti i prodhimit jo më poshtë se 1998”.
- Sa më sipër Operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik të kërkuar në Dokumentat Standarte (kapaciteti teknik) pika 10 për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, germa “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 28, pika 5, germa (ç) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, referuar dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.
- Gjithashtu Operatori ekonomik Victoria Invest ka lidhur me Bashkinë Tirane kontratën Nr. 6556/5 Prot. , datë 08.05.2015 me objekt: “Pastrimi i pjesës Lindore 3 të qytetit të Tiranës” e cila ka përfunduar më datën 08.06.2015. Në përfundim të kontratës në dokumentacionin e mbajtur nga Bashkia Tirane mbi dorëzimin e kontenerëve dhe pikave të vendgrumbullimit të mjetëve është reflektuar fakti se operatorit ekonomik “Victoria Invest” nuk ka dorëzuar sasine e plotë të kontenerëve pronë e Bashkisë Tiranë të cilët kanë qënë nën administrimin e shoqërisë në periudhën e zbatimit të kontratës.
- Përsa më sipër, operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k nuk ka mbyllur detyrimet kontraktuale me Bashkinë Tiranë në lidhje me kontratën Nr. 6556/5 Prot. datë 08.05.2015 duke patur detyrim ndaj Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë në vlerën

7,069,200 (shtatë milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë detyrim për të cilin Shoqëria është vënë në dijeni nëpërmjet korespondencës me Bashkinë e Tiranës.

- Në mbështetje të pika 4, të nenit 77, Mbikqyrja e Kontratës, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor ka mbajtur dokumentacion të plotë që reflekton detyrimin e operatorit ekonomik ndaj Autoritetit Kontraktor dhe mospermbushje të detyrimeve kontraktuale të kontratës
- Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 46, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, Operatori Ekonomik nuk mund të kualifikohet pasi ka detyrim ndaj Bashkisë Tirane duke mos krijuar besueshmëri dhe kredibilitet.

4. Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk konstatoi se ky Operator ekonomik nuk ka paraqitur “Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore”, cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, pika 1.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk konstatoi se Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar, Ekstrakti mbi Historikun e subjektit si dhe Vërtetimi me Nr. 1903/1 Prot. i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës mbi shlyerjen e detyrimeve fiskale si dhe sigurimeve shoqërore janë lëshuar më datë 10.02.2016. Procedura e prokurimit me objekt: “Pastrimi i pjesës Perëndimore-3 të Qytetit të Tiranës” është zhvilluar më datë 01.06.2016. Në këtë mënyrë Shoqëria “Rinia 96” shpk nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të DST, pika 2 ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Keto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.”*
- Shoqëria “Rinia 96” shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 5 “Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve Teknike” në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 1 gërma “a”.
- Shoqëria “Rinia 96” shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 6 “Deklaratë mbi konfliktin e interesit” në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 1 gërma “b”.
- Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik Vërtetim Debie me Nr. 504 Prot. datë 15.02.2016 sipas së cilës rezulton se nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike deri në datën 11.02.2016 pa përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2016. Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.* Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që

tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit të publikuar më datë 22.04.2016 dhe zhvilluar më datë 01.06.2016.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “ç” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 28, pika 4 gërma “ç” ku ndër të tjera citohet se *”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”*.

- Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk nuk plotëson dokumentat e tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 1 pasi nuk ka paraqitur Kopje të certifikuar të Bilancit për vitin ushtrimor 2015.
- Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk ka paraqitur Vërtetimin me Nr. 1903/2 Prot. datë 26.02.2016 lëshuar nga Administrata Tatimore mbi deklarin e xhiros për vitin 2012, 2013 dhe 2014. Shoqëria “Rinia 96” shpk nuk ka paraqitur Xhiron vjetore per vitin 2015 cka bie në kundërshtim me dokumentat e tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë kopje të deklarinimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2013, 2014, 2015) lëshuar nga Autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: **189,069,931** (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.”*
- Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk ka paraqitur si shërbime të ngjashme vetëm Kontratën me Nr. 3548 Prot. datë 24.12.2014 të lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Krujë, me objekt “Për Pastrimin e qytetit Fushë Krujë”, me vlerë 16,899,706 lekë.

Sa më sipër konkludohet se Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk nuk plotëson Kriteret e

Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1 ku për të vërtetuar përvijën e mëparshme Operatorët ekonomik pjesmarrës duhet te paraqesin shërbime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit në vlerën 75,627,972 (shtatëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e njëzetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

Gjithashtu për Kontratën me Nr. 3548 Prot. datë 24.12.2014 të lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Krujë, me objekt “Për Pastrimin e qytetit Fushë Krujë”, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Situacionet për shërbimet e kryera dhe Vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror mbi realizimin me sukses te kontrates së sipërcituar cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 1 gërma “a”.

- Në këtë mënyrë shoqëria “Rinia 96” shpk nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1 cka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 46, pika 1 gërma “b” si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 28, pika 3.

- Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk nuk ka paraqitur Deklaratë për Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për Zonën Perëndimore-3 cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.
- Shoqëria “Rinia 96” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka pjesë të stafit teknik Inxhinier Mekanik dhe Inxhinier Kimist ose Mjedisi duke mosplotësuar Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3.
- Referuar DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 4 është përcaktuar se *“Operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të kenë një punësim mesatar i të paktën 100 (njëqind) personave, për periudhën **Janar 2015- Mars 2016** të vërtetuar me:*

a) *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën **Janar 2015 – Mars 2016**.*

b) *List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen **Janar 2015 – Mars 2016** shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.”*

Operatori ekonomik në Vertetimin e lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën **Janar 2015 – Janar 2016** rezulton të ketë një numër mesatar prej 16 punonjësish cka bie në kundërshtim me DST, pikën e sipërcituar pasi numri i punonjësve që disponon kjo shoqëri është nën numrin e kërkuar, si dhe nuk i korespondon periudhës së kërkuar në DST pasi mungon muaji Shkurt 2016 dhe Mars 2016.

- Në këtë mënyrë shoqëria nuk zotëron kapacitet te mjaftueshem teknik per sa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi duke mos permbushur Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshua) ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

b) *Aftësia teknike ;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,..reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.....*

- Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk nuk disponon certifikat ISO 9001-2008 cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk nuk disponon certifikat ISO 14001-2004 cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk nuk disponon certifikat BS OHSAS 18001-2007 cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Operatori ekonomik “Rinia 96” shpk nuk ka paraqitur Liçensë profesionale e Shoqërisë të vlefshme me kategorinë NP-12 (punime te inxhinierise se mjedisit),

sipas modelit të lëshuar nga MPPTT cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 9.

- Gjithashtu Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se disponon makineritë e kërkuara sipas DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 10, cka bie në kundërshtim me Nenin 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 28, pika 5, gërma “ç”, sipas të cilave parashikohet kualifikimi për **aftësitë teknike** të kandidatëve ofertues, shoqëria “Rinia 96” shpk, nuk ka kapacitetin e duhur teknik për përmbushjen me sukses të kontrates objekt prokurimi.
- Gjithashtu Shoqëria ‘Rinia 96’ shpk nuk ka paraqitur Specifikimet Teknike, metodologjinë e punës dhe grafikonun e shërbimeve cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12.

5. Operatori ekonomik “Rej” shpk

- Operatori ekonomik “Rej” sh.p.k ka paraqitur Vërtetimin me Nr. 4430 Prot. datë 22.02.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, për xhiron mesatare të tre viteve të fundit 2013, 2014, 2015. Në bazë të këtij dokumenti rezulton se xhiroja mesatare vjetore për vitet ushtrimore 2013, 2014, dhe 2015 është në vlerën **165,726,056** (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e njëzetë e gjashtë mijë e pesëdhjetë e gjashtë) lekë. Referuar DST, Kriterete Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2 përcaktohet se: *“Ofertuesi duhet të dorëzojë kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2013, 2014, 2015) lëshuar nga Autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: **189,069,931** (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.”*. Pra Operatori ekonomik nuk plotëson dokumentat standarte te tenderit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2 cka bie ne kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 46, pika 1, gërma “c” si dhe me VKM-në Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 28, pika 4 gërma “b”, pasi shoqëria “Rej” shpk nuk ka kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën.
- Për të vërtetuar përvojën e sukseshme Shoqëria “Rej” shpk ka paraqitur Kontratën me objekt: “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit” të lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Pogradec. Kontrata e paraqitur është realizuar në bashkëpunim me Shoqërinë “Shpresa” shpk dhe është në vlerën 165,052,087 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni shoqërues KVO konstatoi se nuk përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes për secilin anëtar të bashkimit cka e bën të pamundur vlerësimin mbi përvojën e suksesshme në realizimin e shërbimeve të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit.
- Operatori ekonomik “Rej” shpk ka deklaruar si drejtues teknik Ing. Znj. Diana Oshafi (Murati). Nga dokumentacioni shoqërues KVO konstatoi se Shoqëria ‘Rej’ shpk nuk ka paraqitur librezën e punës për Ing. e sipërcituar. Gjithashtu nga dokumentacioni shoqërues nuk provohet eksperiencia e punës (jo më pak se 5 vjet) në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit për Drejtuesen Teknike të deklaruar nga kjo shoqëri. Sa më

sipër Shoqëria "Rej" shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 5.

- Referuar DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 4 është përcaktuar se *"Operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të kenë një punësim mesatar i të paktën 100 (njëqind) personave, për periudhën Janar 2015- Mars 2016 të vërtetuar me:*

c) *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2015 – Mars 2016.*

d) *List pagesat e punonjesve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2015 – Mars 2016 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore."*

Operatori ekonomik në Vertetimin e lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën **Janar 2015 – Mars 2016** rezulton të ketë një numër mesatar prej **80 punonjësish** cka bie në kundërshtim me DST, pasi numri i punonjësve që disponon kjo shoqëri është nën numrin e kërkuar (100 punonjës).

- Në këtë mënyrë shoqëria nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik per sa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi duke mos permbushur Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" (i ndryshua) ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

b)Aftësia teknike ;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,,reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.....

- Gjithashtu Shoqëria "Rej" shpk nuk ka paraqitur Specifikimet Teknike, metodologjinë e punës dhe grafikun e shërbimeve cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "Alko-Impex General Construction" Degë e shoqërisë së huaj**, me adresë: Rruga "Reshit Petrela", Kompleksi Usluga, Kati i 8, pranë Stacionit të Trenit, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **184,834,584** (njëqind e tetëdhjetë e katër milion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar , oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **188,907,876** (njëqind e tetëdhjetë e tetë milion e nëntëqind

e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në Nenin 58 pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 21.06.2016

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur një ankesë, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën me Nr. 20019 Prot. datë 27.06.2016 për trajtimin e së cilës është ndjekur procedura e parashikuar në Kreun VII, Neni 63, pika 3 dhe pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun X, Neni 78 pika 5 dhe pika 6 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në përfundim i është kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës me Nr. 20019/2 Prot. datë 04.07.2016.

